

TË HUMBASËSH VIRTYTIN E MIRËSISË

G.K. Chesterton, në një nga librat e tij, ka shkruar: «Armiqtë e fesë nuk mund të gjejnë rehat. Ata përpiqen pa pushim ta shkatërrojnë atë. Në fakt ata nuk mund ta shkatërrojnë fenë, por, si rezultat, shkatërrojnë çdo gjë tjetër.» Një nga gjërat që ateistët shkatërrojnë në këtë përpjekje të dëshpëruar është morali dhe standartet e tij. Filozofitë ateiste në mënyrë të rafinuar i kanë shkatërruar themelet e moralit. Shoqëria e sotme amerikane, ashtu si shoqëria shqiptare dhe shumë shoqëri të tjera në botë, reflekton vlerat e deformuara të moralit, të cilat kohë më parë profeti Isaia i dënoi me këto fjalë: «Mjerë ata që e quajnë të mirën të keqe dhe të keqen të mirë, që ndërrojnë terrin me dritë dhe dritën me terr, që kthejnë hidhësinë në ëmbëlsi dhe ëmbëlsinë në hidhësi!» (Isaia 5:20).

Si rezultat i ndikimit të filozofisë ateiste shoqëria moderne i ka kufizuar apo ndaluar liritë e ushtrimit të besimit në Perëndi në shumë raste. Një raport i Unionit Amerikan të të Drejtave Civile thotë: «U.A.D.C. ka qenë në gjendje të frenojë shprehjen publike të besimit, duke përmbushur në këtë mënyrë qëllimin e tij.» Në SHBA, në gjykata, shkolla dhe në institucione të tjera ne jemi të detyruar të heshtim kur vjen fjala për çështjet fetare. Kundërshtarët e zhurmshëm të fesë kanë ndikuar çdo aspekt të jetës, që nga familja deri te qeveria. Njeriu e konsideron veten si të jetë «vetë zot e vetë shkop» dhe, si rrjedhim, sjellja e tij karakterizohet nga arroganca dhe banaliteti. Kjo është pasojë e influencës së

ateizmit! Idetë ateiste kanë patur sukses në frenimin e shprehjes së lirë të besimit në Perëndi, por, në të njëjtën kohë, ato kanë ekspozuar gabimet e ateizmit. Me pak fjalë, kjo «fitore» e ateizmit tregon se ai nuk është aspak në gjendje të prodhojë «mirësi» në shoqëri.

Çdo shoqëri ka «kodin e vet të detyrimeve morale», i cili krijon themelin për ligjin, drejtësinë dhe për mirëqenien e kësaj shoqërie. Këto «detyrime morale» kanë një qëllim në vetvete. Kur eliminojmë «detyrimet morale», ne eliminojmë qëllimin për jetën dhe kjo, si rezultat, shkakton kaosin. Ravi Zacharis na ka dhënë një shembull të mirë për ta shpjeguar këtë. Ora e dorës ka një qëllim të thjeshtë, të tregojë kohën. Nëse dikush na pyet se ç'është një orë dore, ne mund të flasim sa të duam për formën, ngjyrën, madhësinë e saj e kështu me radhë. Por, nëse ne nuk themi se ora shërben për të treguar kohën, ne s'kemi thënë asgjë që e ndihmon bashkëbiseduesin tonë të kuptojë se për ç'farë po flasim. Sido që ta përshkruajmë një orë, ne nuk duhet të harrojmë të themi që ajo na tregon kohën. Ora është krijuar për një qëllim të caktuar. Kur e humb atë cilësi (kur nuk është më në gjendje të tregojë kohën e saktë), ajo humb qëllimin e ekzistencës së saj! E njëjta gjë është e vërtetë për shoqërinë njerëzore. Kur shoqëria humb apo shpërfill «detyrimet e saj morale» (aftësinë për të dalluar të mirën nga e keqja), ajo në të njëjtën kohë humbet qëllimin e ekzistencës së saj. Kur qytetarët humbasin qëllimin

e jetës, ata të hutuar pyesin: «Pse jemi këtu në këtë botë? Çfarë duhet të bëjmë?» Që nga fillimi i ekzistencës së tij (në kopshtin e Edenit), qëllimi i njeriut (ajo që ai duhet të bëjë) ka qenë dhe do të jetë adhurimi i Perëndisë në qiell nëpërmjet jetës së tij. Kur njerëzit humbasin këtë ndërgjegjësim për atë që «duhet» të bëjnë, ata humbasin qëllimin dhe kuptimin e jetës.

Është mungesa e qëllimit për jetën që nxjerr në pah dështimin e ateizmit. Një botë e krijuar nga hiçi (siç shpjegohet nga ateizmi) nuk ka ndonjë «kod moral» apo ndonjë bazë prej nga mund të nisesh për të dalluar të mirën nga e keqja. Si mundet një shoqëri që nuk pranon besimin kristian të kërkojë nga qytetarët e saj që të sillen sipas moralit kristian? Bibla vazhdimisht i paralajmëron ata që mohojnë Perëndinë, se pasojat e këtij mohimi kanë efekt shumë të madh për jetën e tyre (shikoni Romakëve 8:5-7; 1 Korintasve 2:14; Galatasve 5:17; Efesianëve 2:1-3, 4:17-19; Titit 3:3). Kur një njeri mohon Perëndinë, ai s'ka më arsye të zbatojë «detyrimet morale» të jetës. Kjo është me pasojat tragjike. Këto pasoja shpesh vijnë menjëherë dhe më pas ai vuan prej tyre për një kohë të gjatë.

Ai që nuk beson në ekzistencën e Perëndisë do të gjendet në mes të furtunave të jetës, pa asnjë drejtim apo udhëzim. Ai do të jetojë pa patur një qëllim në jetë. Ky njeri do të jetë gjithmonë i shqetësuar nga pyetja të cilës s'mund t'i përgjigjet: «Cili është qëllimi i jetës sime?»

Nuk ka ndonjë alternativë tjetër për ata që mohojnë Perëndinë. Vëreni se si ateizmi nuk paraqet ndonjë alternativë të përshtatshme për jetën, sepse ai eliminon plotësisht virtytin e mirësisë në shoqërinë njerëzore.

THEMELET E MORALIT

«Moralit» është, me pak fjalë, standarti që çdo njeri përdor për të përcaktuar ç'është e mirë dhe ç'është e keqe. Çdo standart moralit e ka një origjinë dhe kjo origjinë influencën çdo vendim që marrim. Besimi kristian ka një moral të caktuar. Edhe ateizmi ka një moral të vetin.

C.S. Lewis, një mbrojtës i njohur i fesë kristiane, sugjeron tre aspekte të cilat duhet të merren në konsideratë për të vendosur nëse standartet morale që përdoren nga një shoqëri janë të dobishme për të apo jo. Ai përdor metaforën e anijeve që lundrojnë në oqean. E para, anijet duhet të dinë si të evitojnë

përplasjen me njëra-tjetrën. Kjo krijon standartin për *moralin social* (moralin shoqëror). Ne duhet të jemi në gjendje që të jetojmë pa ndërhyrë në të drejtat e të tjerëve. E dyta, anijet duhet të dinë se si të ruajnë formën e tyre në mënyrë që të mos fundosën. Kjo krijon standartin për *sjelljen individuale* (ose siç mund ta quajmë *moralin personal*). Në qoftë se duam të evitojmë tragjedinë në jetën tonë personale, ne duhet të dimë se çfarë virtytesh të marrim, se çfarë vesesh të lemë mënjanë dhe se çfarë karakteri duhet të ndërtojmë. E treta, anija duhet ta dijë se pse po lundron në oqean. Ajo duhet të dijë se për ku po lundron. Kjo tregon standartin *filozofik të moralit*. Ne duhet të njohim arsyet e ekzistencës onë.

Bibla jep shpjegime të qarta për këto tre themelet të moralit. Bibla na tregon si të veprojmë si individë dhe si të veprojmë si pjesë e shoqërisë. Gjithashtu, Bibla na jep arsyen e ekzistencës sonë. Ka shumë pjesë në Bibël që shpjegojnë arsyen e ekzistencës së njeriut. Por 2 Timoteut 3:17 e përmbledh këtë shumë shkurt dhe qartë: «Që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.»

Ateizmi nuk është në gjendje që të krijojë një moral të dobishëm duke përdorur këto tre standarte. Ateizmi njëherazi hedh poshtë dy standartet e fundit dhe praktikisht shpërfill standartin e parë! Kështu, ateizmi ka shkaktuar shthurjen e moralit.

SHTURJA E MORALIT

Meqenëse ateizmi e ka eliminuar «pse»-në e ekzistencës njerëzore, ata që ndjekin filozofitë e tij në mënyrë të pashmangshme vendosin që të kenë një jetë plot me tragjedi. Shikoni shoqërinë tonë dhe vini re se si morali i vërtetë (i ardhur nga Bibla) nuk ekziston më.

E para, neve na premtohen «liri» të pakufizuara dhe, si rezultat, ne e kuptojmë se izolohemi gjithnjë e më shumë. Në emër të «lirive» tona (liria e fjalës dhe e individit) ne gati e kemi shkatërruar moralin themelor! Virtytet e respektit, nderit, të së vërtetës dhe dhembshurisë gati janë sakrifikuar nën parullën: «*Secili vetëm për veten e vet.*» «Mbretërit e pornografisë» jetojnë në luks, sepse ata gëzojnë «lirinë» e fjalës. Homoseksualiteti është përhapur për arsye të «lirisë» së individit. Këto janë liri që e dëmtojnë si shoqërinë ashtu edhe individin (2 Pjetër 2:18-19).

E dyta, morali i vërtetë sulmohet me përçmim

dhe tallje. Ai konsiderohet si diçka e vjetër dhe e dalë jashtë mode. Në vend të tij krijohet një moral i ri, në të cilin e drejta absolute apo e gabuara absolute nuk ekzistojnë! Ç' do të thotë e gjitha kjo? Shumë vendime që kanë të bëjnë me moralin e individit apo edhe të shoqërisë sot merren nën ndikimin e ndjenjave të momentit dhe jo me anë të të menduarit. Shoqëria e sotme njerëzore pretendon se është e dedikuar të «kujdeset» për të varfërit dhe të persekutuarit e kësaj bote. Filozofia Ateiste thotë se vetëm njeriu mund ta shpëtojë këtë botë dhe njerëzit që janë në të nga problemet e shumta. Cili është qëllimi i kësaj «përkujdesjeje»? Mbi ç' moral bazohet kjo thirrje e ateizmit për të treguar dhembshuri? Meqenëse ateizmi nuk e përfill Perëndinë, ai nuk mund t' u përgjigjet këtyre pyetjeve!

PASOJAT E MORALIT ATEIST

Çfarë ndodh kur njeriu përpiket të jetojë sipas ligjeve të krijuara prej tij duke mos i përfillur ligjet dhe moralin e Perëndisë? Pasoja tragjike vijnë. Te Romakëve 1:21–22 thuhet: «Sepse, megjithëse e njohën Perëndinë, nuk e përlëvduan as e falenderuan si Perëndi, përkundrazi u bënë të pamend në arsyetimet e tyre dhe zemra e tyre pa gjykim u errësua. Duke e deklaruar veten të urtë, u bënë të marrë.» Ky varg ilustron më poshtë:

E para, jetët e atyre që e kanë mohuar Perëndinë janë një shembull që tregon se sa pervers (i pështirë) është morali i «krijuar» nga njerëzit. Jetët e figurave historike si Karl Marks, Sarter, Rusell dhe të shumë të tjerëve tregojnë se ata që besojnë në moralin e vetvetes do të bëjnë një jetë pa kuptim. Në marrëdhëniet e tyre do të mungojë dedikimi dhe besnikëria do të jetë një ëndërr e paarritshme. Adolf Hitleri ishte një njeri i tillë. Fjalët e Hitlerit në kampin e përqëndrimit në Auschwitz shërbejnë si një përmbledhje për qëllimin e moralit të krijuar prej vetvetes. Ja një pjesë nga fjalimi i tij: «Unë e shpëtova Gjermaninë nga gabimet idiote dhe degraduese të ndërjegjes dhe të moralit... Unë dua që të rinjtë të jenë në gjendje të ushtrojnë dhunën, të jenë arrogantë, të ashpër dhe të pamëshirshëm.» Këto qëllime u realizuan gjatë qeverisjes së Hitlerit dhe të gjithë ne e dimë se ç' pasoja tragjike patën ato. Hitleri s' ishte njeriu i fundit që mendonte në këtë mënyrë. Shumë njerëz sot jetojnë në bazë të moralit që ata vetë e krijojnë. Kështu, vlera e jetës injorohet sot nga ata që mbështesin abortin dhe nga

«vrasësit e mëshirshëm» (mjekët që e kryejnë abortin me duart e tyre). Morali i ardhur nga vetë njerëzit justifikon vrasjen e atyre që nuk janë «të përshatshëm» dhe të atyre që nuk janë «të aftë» për të jetuar si «qytetarë të dobishëm».

E dyta, mbijetesë është i vetmi qëllim i moralit ateist. Meqenëse besimi te Perëndia mungon, atëherë nuk ka detyrime morale për të ndihmuar të tjerët duke sakrifikuar veten. Ata që nderoheshin si «heronj» në të kaluarën, për arsye të sakrificave personale për të mirën e të tjerëve, konsiderohen sot si «budallenj» nga filozofia ateiste. Cila është arsyeja për të sakrifikuar sipas ateizmit? As që ekziston fare! Një nga pasojat e hidhura të ateizmit është se njerëzit mendojnë vetëm për veten e tyre dhe nuk e prishin terezinë fare për të tjerët.

E treta, dhuna është një nga rezultatet më të këqija të ateizmit. Ata njerëz që kujdesen vetëm për vete janë gati t' u bëjnë çdo gjë të tjerëve, për të kënaqur interesat e tyre. Sipas ateizmit, nuk ka *asgjë të keqe* po të vrasësh, të përdhunosh, të torturosh apo të bësh diçka tjetër të keqe. Gjithçka justifikohet nga «nevoja për mbijetesë». Ata njerëz që influencohen nga morali ateist kanë më shumë keqardhje për vrasësin se sa për viktimën e tij. Ata ndjejnë më shumë keqardhje për atë që prish marrëdhënien bashkëshortore se sa për gjithë familjen që e vuan këtë akt. Ateizmi bën që njerëzit të besojnë se viktima është fajtori i vërtetë dhe jo ai që kryen krimin.

E katërta, ateizmi shkakton një rrënim të pafund të vlerave të jetës. Dikush ka shkruar: «“Vdekja e Perëndisë” e propaganduar nga ateistët ka shkatërruar moralin që i jep kuptim jetës. Por kjo krijon problemin se si dhe nga do të vijë morali për shoqërinë dhe individin?» Kjo është një ide interesante. Në qoftë se morali ateist do të vazhdojë të përhapet në njerëz, kjo do të sjellë fundin e moralit të vërtetë!

KONKLuzioni

Ne kemi parë dy standarte të moralit. I pari, kristianizmi, është i logjikshëm. Ai i jep jetës kuptim dhe qëllim dhe është i dobishëm për individin dhe për shoqërinë. Kristianizmi përmban shpresën për jetëzgjatjen e shoqërisë. Ateizmi garanton një jetë të pamëshirshme dhe të vështirë. Ateizmi nuk ofron shpresë dhe kuptim për jetën njerëzore. Njeriu që nuk beson në Perëndi udhëhiqet vetëm nga qëllime

egoiste. Ai është gati të shkatërrojë edhe themelet e shoqërisë për të realizuar qëllimet e tij.

I vetmi kod që përmban çfarë duhet të bëjë dhe

çfarë nuk duhet të bëjë njeriu, i vetmi kod që i jep kuptim jetës së individit dhe të shoqërisë është Fjala e Shenjtë e Perëndisë, Bibla!

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: "*Perëndia kundër ateizmit*"
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara